



Funded by
the European Union

Regional Programme on Local Democracy on the Western Balkans 3 ReLOaD3



FTESË PËR PJESËMARRJE NË SESIONET E MENTORIMIT NË KUADËR TË THIRRJES SË PARË PUBLIKE PËR ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE PËR PROJEKT PROPOZIME NË SHKODËR

Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 3 (ReLOaD3) është një iniciativë e financuar nga Bashkimi Evropian (BE) dhe e zbatuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (PNUD) në gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor, përfshirë Shqipërinë. Ky program është vazhdim i nismës së mbështetur më parë - ReLOaD1 dhe ReLOaD2 të zbatuar në periudhën tetë vjeçare 2017-2024. Faza e tretë e programit ka filluar më 1 Shkurt 2025 dhe do të vazhdojë deri në 31 Janar 2029. ReLOaD3 synon fuqizimin e shoqërisë civile për t'u angazhuar në mënyrë aktive në vendimmarrje dhe mbikëqyrjen qytetare, ndërsa nxit qeveritë të krijojnë një mjedis mbështetës politik, ligjor dhe financiar për shoqërinë civile. ReLOaD3 do të punojë me qeveritë vendore (bashkitë) dhe do t'i nxisë ato të përdorin fondet publike për OShC-të në mënyrë transparente dhe të orientuar drejt zhvillimit, duke marrë parasysh nevojat vendore dhe duke përqafuar një qasje të bazuar në projekt.

Në kuadër të Thirrjes së parë publike për OShC-të për projekt propozime, në partneritet me programin ReLOaD3 në Shqipëri, ju informojmë se Bashkia Shkodër organizon sesione mentorimi sipas agjendës dhe detajeve në vijim:

Data	Ora	Tematika e sesionit	Vendi
29 Dhjetor 2025	09:00 – 10:30	Korniza logjike	Platforma ZOOM https://undp.zoom.us/j/86511541653?pwd=Pzj33Bljyk5Fvr0Y7nNW9rGGSXJK8q.1
	10:30 – 12:00	Projekt propozimi	Meeting ID: 865 1154 1653
	13:00 – 14:30	Buxheti dhe Plani i aktiviteteve	Passcode: 976332
	14:30 – 16:00	Çështje të tjera të aplikimit	

Gjatë këtyre sesioneve, një ekspert i fushës do të japë mbështetje për organizatat në çështjet e mësipërme. Organizatat e interesuara për të marrë pjesë në sesionet e mentorimit duhet të dërgojnë një email duke cituar datën dhe sesionin/et që janë të interesuar të marrin pjesë.

Ju lutem konfirmoni pjesëmarrjen tuaj në adresën planifikimistrategjik@bashkiashkoder.gov.al dhe reload.al@undp.org.